

University of Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Spring 5-2021

### Përdorimi i vitaminës D në regjionin e Ferizajit

Ermelinda Neziri

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Medical Sciences Commons](#), and the [Nursing Commons](#)

---



Kolegji UBT  
Fakulteti i Infermerisë

**Përdorimi i vitaminës D në regjionin e Ferizajit**

Shkalla bachelor

Ermelinda Neziri

Maj/2021/Prishtinë



Kolegji UBT  
Fakulteti i Infermerisë

Punim diplome  
Viti akademik 2017/2018

Ermelinda Neziri

**Përdorimi i vitaminës D në regjionin e Ferizajit**

Mentori: Dr. sci. Valon Ejupi

05/2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesshme për shkallën bachelor.

## **Abstrakt**

Njohurite për vitaminat janë një çështje që secili njeri duhet t'i ketë, dhe që çdo infermier duhet që të informojë pacientët dhe të tregojë një kujdes të veçantë.

Objektivi i temës do të jetë zgjerimi i njohurive rreth rolit dhe rëndësisë së përdorimit të vitaminës D. Një vend të posaqëm do të ketë shqyrtimi i mungesës dhe përdorimi jo adekuat të vitaminës D duke pasur për fokus pasojat të cilat rezultojnë në këto raste. Duke zgjeruar këto njohuri, synoj që të njëjtat të përdoren nga infermieret në mënyrë që një numër i madh i keqformimeve si rezultat i deficeinces së vitaminës D të evitohen, e procese të shumta të varura nga kjo vitamin të mund të zhvillohen pa pengesa.

Gjatë punës sime në këtë temë, do të diskutohen rreth ndërlidhjes së shumë proceseve të cilat vazhdimisht zhvillohen nga vitamina D, do të shqyrtoj metabolizmin e saj si dhe nevojat ditore të rekomanduara që secili nga ne duhet që ti plotësoj. Një rëndësi të veçantë do të kushtohet sëmundjeve të cilat vijnë si rezultat i mungesës së vitaminës D, trajtimit të tyre dhe kujdesin infermieror në këto raste, që poashtu është ndër objektivat kryesor të këtij punimi.

Tema në pjesën e përgjithshme do të përfshijë një shqyrtim të literaturës ku janë dhënë një numër i madh i rasteve të cilat kanë përgjigje rreth atyre që u diskutuan më lartë. Rëndësi të posacme i është kushtuar pjesës speciale, pjesa e punës sime, ku nga të dhënat e marra përmes pyetësorëve tek pacientët dhe puntorët shëndetësor, kemi siguruar të dhëna të rëndësishme rreth asaj se sa kanë njohuri rreth vitaminës D, sa është përdorimi i saj, cilat janë rrugët e përdorimit etj. Të dhënat përfshijnë vetëm regjionin e Ferizajit në periudhën 2020-2021.

Identifikimi i hershëm, vlerësimi dhe trajtimi i deficinës së kësaj vitamine, e vërtetohet me anë të testeve specifike, do të ndikojë në mënyrë direkte në përmirësimin e kualitetit të jetës së pacientit dhe parandalimin e një numri të madh të sëmundjesh përcjellëse.

## **Mirënjohje / Falënderime**

Nuk do të mund ti përkufuzoja të gjitha momentet, emocionet si dhe ditët e mira që kalova në studimet bachelor në degën infermeri si dhe në përfundim do të shprehi mirënjohjen për disa persona të veçantë të cilët më ndihmuan në përmbushjen e studimeve të mia, pa të cilët nuk do të mund të isha këtu.

Falënderim i veçantë shkon për familjen timë të cilës i detyrohem shumë për fillimin dhe finalizimin me sukses të këtij udhëtimi sa të vështirë aq edhe shumë të bukur. Ishin ata të cilët më besuan dhe nuk ndaluan së dhëni përkrahje dhe forcë për të vazhduar më tutje dhe po ashtu më ndihmuan financiarisht shumë.

Gjithashtu, i falënderoj të gjithë njerëzit të cilët pranuan të bëheshin pjesë e hulumtimit, si dhe mjekë të klinikave dhe poliklinikave të cilët po nuk kanë heziturar për të marrë pjesë.

Dëshiroj në fund të falënderoj profesor Dr. sci. Valon Ejupin për kontributin e dhënë në finalizimin e punimit të diplomës.

Falënderojë/ përzemërsisht të gjithë!

Maj, 2021

Prishtinë

## **Fjalori i termave**

CF – Fibrozë Cistike.

CKD – Sëmundje kronike e veshkave.

SHPAT – Hiperparatiroidizëm sekondar.

KDOQI – Nisma për cilësinë e rezultateve të sëmundjeve të veshkave.

KDIGO – Është organizata globale jofitimpruese që zhvillon dhe zbaton udhëzime të praktikës klinike të bazuar në prova dhe në sëmundjen e veshkave.

VDRA – receptori i vitaminës D.

PTH – Parathormoni.

AITD – sëmundje autoimune të tiroidës.

IDDM – Diabeti mellitus i varur nga insulina.

MS – Skleroza multiple.

IBD – sëmundje inflamatore e zorrëve.

SLE – lupusi eritematoz sistematik.

RA – artriti reumatoid.

CVD – sëmundjet kardiovaskulare.

CV – kardiovaskular.

## Përmbajtja

HYRJE .....	8
SHQYRTIMI I LITERATURËS .....	9
FUNKSIONI BIOKIMIK I VITAMINAVE.....	10
<i>Vitaminat liposoluipe</i> .....	12
<i>Vitaminat hidrosoluipe</i> .....	12
KALCIFEROLI, KALCIOL, KALCITROL (VITAMINA D).....	13
<i>Mungesa e vitaminës D</i> .....	16
VITAMINA D DHE SËMUNDJA E MUSHKËRIVE ME FIBROZË CISTIKE (CF) .....	18
VITAMINA D SI NJË TERAPI ANTI -MIKROBIKE DHE ANTI-INFLAMATORE PËR FIBROZË CISTIKE (CF) .....	18
VITAMINA D NË SËMUNDJEN KRONIKE TË VESHKAVE PARA-DIALIZËS.....	19
VITAMINA D NË PACIENTËT ME SËMUNDJE KRONIKE TË VESHKAVE (CKD) DHE DIALIZË.....	20
VITAMINA D DHE SËMUNDJET AUTOIMUNE .....	21
<i>Vitamina D dhe sëmundjet autoimune të tiroides</i> .....	22
<i>Rëndësia e niveleve të vitaminës D në sëmundjet autoimune</i> .....	22
VITAMINA D DHE DEPRESION: MEKANIZMAT, PËRCAKTIMI DHE APLIKIMI .....	23
VITAMINA D DHE SHËNDETI -VITAMINA E HUMBUR TEK NJERËZIT .....	23
ROLI I VITAMINËS D NË: FERTILITET, SHTATZANI DHE NË LAKTACION.....	24
VITAMINA D DHE PARANDALIMI OSE TRAJTIMI I GRIPIT .....	25
VITAMINA D NË ORTOPEDI .....	25
ROLI I VITAMINËS D NË SËMUNDJET KARDIOVASKULARE (CVD).....	25
BIOSINTEZA.....	26
SINTEZA NË LËKURË.....	26
METODOLOGJIA .....	28
PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE .....	29
<i>Prezantimi i rezultateve</i> .....	29
<i>Analiza e rezultateve</i> .....	29
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....	30
REFERENCAT.....	42

## Lista e tabelave

TABLE 1: VITAMINAT LIPOSOLUIBE .....	11
TABLE 2: VITAMINAT HIDROSOULIBE .....	11
TABLE 3: STRUKTURA KIMIKE E VITAMINAVE D1, D2, D3, D4, D5.....	16
TABLE 4: NË CILËN MOSHË KANË DËGJUAR PËR VITAMINËN D .....	31
TABLE 5: SIPAS JUVE PËR ÇKA NEVOJITET VITAMINA D? .....	32
TABLE 6: A KENI PËRDORUR NDONJËHER VITAMINA D?.....	33
TABLE 7: SI DO TA MERRNIT VITAMINËN D NËSE DO TË KISHIT MUNGESË? .....	34
TABLE 8: SA SHPESH JU EKSPLOZOHUNI RREZEVE TË DIELLIT? .....	35
TABLE 9: SA SHPESH E MERRNI VITAMINËN D? .....	36
TABLE 10: A DUHET TË KONTROLLOHET SASIA E VITAMINËS NË ORGANIZËM? .....	37
TABLE 11: A MENDONI QË NËSE VITAMINA D MERRET NË DOZA TË LARTA ËSHTË E DËMSHME PËR ORGANIZMIN? .....	38
TABLE 12: A KENI PASUR NDONJËHER MUNGESË TË VITAMINËS D? .....	39
TABLE 13: SA SHPESH E MERRNI ME VITAMIN D? SHPESH, RRALL, NDONJËHER .....	40
TABLE 14: INTERVISTAT ME MJEKËT .....	41

## Lista e figurave

FIGURE 1: NË CILËN MOSH KENI DËGJUAR PËR VITAMINËN D?.....	31
FIGURE 2: SIPAS JUSH PËR ÇKA NEVOJITET VITAMINA D? .....	32
FIGURE 3: A KENI PËRDORUR NDONJËHER VITAMINËN D? .....	33
FIGURE 4: SI DO TA MERRNIT VITAMINËN D NËSE KENI MUNGES? .....	34
FIGURE 5: SA SHPESH JU EKSPLOZOHUNI RREZEVE TE DIELLIT? .....	35
FIGURE 6: SA SHPESH E MERRNI VITAMINËN D?.....	36
FIGURE 7: A DUHET TË KONTROLLOHET SASIA E VITAMINËS D NË ORGANIZËM? .....	37
FIGURE 8: A MENDONI QË NËSE VITAMINA D MERRET NË DOZA TË LARTA ËSHTË E DËMSHME PËR ORGANIZMIN? .....	38
FIGURE 9: A KENI PASUR NDONJËHER MUNGES TE VITAMINËS D? .....	39
FIGURE 10: SA SHPESH E MERRNI VITAMIN D? .....	40



## Hyrje

Duke marre parasysh që është një temë e rëndësishme, synojë që të tregojë se çka janë vitaminat, roli i infermierës tek njerëzit, dhe sa përqind e njerëzve kryesisht të regjionit të Ferizajit kanë njohuri për vitaminën D dhe cila është forma më e mirë e marrjes së vitaminës D.

Një punim diplome ka një qëllim dhe një strukturë të caktuar, përmes së cilës studenti përfundon studimet bachelor. Dhe unë jam munduar, përpjekur sigurisht me ndihmën e profesor Dr. sci. Valon Ejupi, t'i përmbahem disa rregullave formale dhe strukturore për të krijuar një punim sa më të plotë. Në fillim, në pjesën e parë jam përpjekur të jap disa koncepte teorike në lidhje me vitaminat dhe ndarjen e vitaminave, si dhe rolin e vitaminës D në sëmundje të ndryshme.

Në pjesën e dytë do të mundohem që të shpalos punimin e pyetësorëve të cilat janë të dhëna të sakta të cilat janë marrë nga të anketuarit në regjionin e Ferizajit, po ashtu është një intervistë e realizuar me mjekët e reparteve. Qëllimi i kësaj pjese është që të hulumohen nëse njerëzit kanë hipovitaminozë apo hipervitaminozë.

Të gjithë dëshirojnë që të jenë të suksesshëm, të arrijnë një karrierë që e kanë synim në mënyrë që të jep kontributin e tij në vendin e tij. Dëshira dhe obligimi për të hartuar një punim të tillë, ka qenë gjithmonë prezent gjatë tërë kohës së punës në këtë temë. Në studimin tim është dashur që të bëhet një hulumtim nga literaturat e ndryshme shkencore të cilat do t'i plotësojnë kërkesat e këtij punimi që del për herë të parë para lexuesit, si dhe kujdesin dhe informatat që tregoi në lidhje me temën Dr. sci. Valon Ejupi. Tema është shtjelluar me kujdes dhe përgatitja e saj do të kontribuojë në literaturën arsimore të mjekësisë që në mënyrë të tillë të kenë njohuri njerëzit për vitaminën D. I falënderohem të gjithë atyre që me vërejtjet dashamirëse, sugjerimet dhe propozimet e tyre më ndihmuan në realizimin e këtij punimi.

## Shqyrtimi i literaturës

Vitaminat janë përbërës të rëndësishëm organik të ushqimit të cilat në sasi shumë të vogël ndihmojnë dhe mbajnë një zhvillim normal të organizmave dhe mikroorganizmave. Ato janë përbërës esencial të ushqimit, sikurse aminoacide esenciale, organizimi vetë nuk mund t'i sintetizojë, prandaj ato në mënyrë permanente duhet të merren me materie ushqyese. Disa vitamina i sintetizojnë bakteriet e florës zorrre të njeriut (*Biokimia.2016. f..438*). Fjala “vitaminat” vjen nga fjala latine (vita- që do të thotë “jetë”).

Në vitin 1880 Christian Eijkman në një eksperiment tek kafshët zbuloi se mungesa e vitaminës dhe ndryshimi i kushteve shkakton sëmundjen e avitaminozës (*Biokimia.,2016. f..438*)

Në vitin 1912, Casimir Funk shpiku fillimisht termin “vitamin”. Periudha kryesore e zbulimit filloi në fillim të shekullit XIX dhe përfundoi në XX. Misteri i secilës vitamin u zgjidh përmes punës dhe kontributeve të epidemiologjisë, mjekëve, fiziologëve dhe kimistëve. Hulumtimet mbi vitaminat që lidhen me sindromat e mungesës kryesore filluan kur teoria e sëmundjes ishte mbizotëruese dhe se vetëm katër faktorë ushqyesh ishin thelbësor: proteina, karbohidrate, yndyrna dhe minerale.

Mjekët shpejt njohin skorbutin, beri-beri, rahitisin, pellagra dhe kseroftalmine si mungesa specifike të vitaminave, sesa sëmundjet për shkak të infeksioneve ose toksinave (*Richard D Semba.2012.f..310*). Fiziologjia eksperimentale me modelet e kafshëve ka luajtur një rol themelor në kërkimin e të ushqyerit dhe e cila ka shkurtuar shumë periudhën e vuajtjeve njerëzore nga mungesat e vitaminave. Në fund të fundit ishin kimistet ata që izoluan vitaminën atë ndryshime ,nxorën strukturën e tyre kimike dhe të cilat kanë zhvilluar metoda për sintezën e vitaminave. Kuptimi ynë për vitaminat e cila ende vazhdon të zhvillohet që nga periudha fillestare e zbulimit (*Richard D Semba.2012.f..310*).

Shkencëtari Polka Kazimir Funk gjatë vitit 1911 izoloi nga orizi një substancë kristallore e cila shëron sëmundjen beri-beri. Substanca e izoluar kishte emrin Amin dhe Funk të cilës ja dha emrin vitamina (amin vita-jetë) (*Biokimia.2016.f..438*). Vitaminat e shumta dhe funksioni i tyre fiziologjik janë zbuluar shumë herët në krahasim me klasifikimin racional të tyre. Për atë shkak u vendos që vitaminat të shënohen me shkronjën të madhe të alfabetit: A.B.C etj. Me njohjen e

funkcionit të tyre fiziologjik, vitaminat marrin emrin në bazë të funksionit të tyre për shembull antiskorbut-vitamin C, ndërsa me njohjen e strukturës së tyre kimike, ndiqet emri kimik i vitaminës (për shembull vitamina B6-piridoksali), (*Biokimia.2016. f.438*).

Nomenklatura e vitaminave e cila përdoret sot është në bazë të strukturës së tyre kimike me mbajtjen e simbolit në bazë të alfabetit (*Biokimia.2016. f.438*). Vitaminat dhe hormonet i takojnë dy kalsave të përbërësve aktiv që janë të ndryshëm në brendinë e tyre. Hormonet janë përbërës që rregullojnë metabolizmin. Për vitaminat është e njohur struktura e tyre, ndërsa disa janë të fituara edhe me rrugë sintetike. Vitaminat e fituara me rrugë sintetike funksionojnë si antimetabolitë, të cilët janë të ndëmshme për njerëzit dhe ndërsa janë të dëmshme për klasa të caktuara të bakterieve. (*Biokimia.2016. f.438*).

### **Funksioni biokimik i vitaminave**

Vitaminat e tretshme në ujë janë rëndësishme si koenzima ose të grupeve prostetike të enzimeve të ndryshme (*Biokimia .2016. f..439*). Metabolitet e vitaminës A dhe D arrijnë të lidhen në proteina specifike në bërthamën e qelizës dhe këtu veprojnë si rregullatorë të transkriptimit të enzimeve dhe proteinave transportuese. Funksioni i vitaminës (E) e mbështet në vetinë e saj si anti-oksiduesë në eliminimin e produkteve të ndërmjetme reaktive të oksigjenit (*Biokimia. 2016. f..439*).

Vitaminat ndahen në dy grupe kryesore (në bazë të asaj se ku treten):

Liposoluibe – të tretshme në yndyrna: A, D, E, K.

Hidrosoluibe – të tretshme në ujë: B, C, H etj.

Table 1: vitaminat liposolubile

Simboli	Emri	Koenzimi	Avitaminoza
A	Retinoli	Nuk është i njohur	Verbërim gjatë natës kseroftallmi
D	Kalciferoli	Nuk është i njohur	Rahitis
E	Tokoferoli	Nuk është i njohur	Dobësim muskular
K	Naftokinoni	Mena-hidrokinoni	Ngadalsim I koagulimit të gjakut

Table 2: vitaminat hidrosolubile

Simboli	Emri	Koenzim	Avitaminoza
B1	Tiamina	Tiamin pirofosfati	Beri-beri
B2 komplekset	Riboflavina	Fad	Dermati
	Nikotinamid	Nad, nadp	Pellagra
	Acidi folik	Acidi tetrahydrofolik	Anemia Megaloblastike
	Acidi pantotenik	Koenzim A	Djegia e kalorive

Mungesa apo mosmarrja e mjaftueshme e vitaminave me anë të ushqimit tek njerzëit dhe gjallesat e tjera çon deri te ndarja e secilit vitamin ose grup të vitaminave, karakteristike ka ulje të metabolizimit normal, i njohur si avitaminozë. Në doza të mëdha të antibiotikëve dhe sulfonamideve, mund të dëmtohen bakteriet e zorrëve, për ta ndaluar atë burim të vitaminave ashtu që mund të paraqiten avitaminoza të rënda dhe përkundër mos ndryshimit të ushqyerjes (*Biokimia*. 2016. f..440).

### **Vitaminat liposoluide**

Të ashtuquajtura si vitamin të tretshme në yndyrna dhe në tretës organik janë apolare, molekulat hidrofille dhe të gjithë të tjerët janë derivate të izoprenit (*Biokimia.2016. f..438*).

### **Vitaminat hidrosoluide**

Vitaminat e tretshme në ujë të grupit B, si dhe vitaminat C dhe H bëjnë pjesë në klasa krejtësisht të ndryshme të substancave. Meqenëse ato nuk mund të ruhen në organizime është i nevojshëm një furnizim i rregullt i tyre nëpërmjet ushqimit si dhe një marrje e tepërt e këtyre vitaminave do të nxirret jashtë me anë të urinës(*Biokimia.2016.f..438*). Vitaminat të cilat zërthehen në ujë kanë struktura të ndryshme kimike por kanë karakteristika të përbashkëta që janë molekula polare dhe për këtë shkak janë të tretshme. Të gjitha vitaminat hidrosoluide mund të sintetizohen nga bimët dhe sigurohen së bashku me leguminozat ,drithërat,perime me gjethe të gjelbërta dhe tharmi ,po ashtu edhe në mish dhe në qumësht(*Biokimia.2016.f..438*). Për shkak të tretshmërisë së tyre në ujë, këto vitamina nuk kanë formë stabile për tu deponuar, për atë duhet vazhdimisht të merren me ushqim. Vitaminat B12 kanë një përjshim dhe ajo në kushte normale për një kohë depozitohet në mëlçi, në sasi që do t'i plotësojë nevojat e organizimit për një kohë të gjatë. Të gjitha këto vitamina funksionojnë si kofaktorë në reaksionet enzimatike ose mund të thuhet që janë kofaktorë, të ashtëquajtura si koenzimet paraqesin vitaminat të modifikuara. Deficitet e vitaminave të tretshme në ujë nuk janë të ralla dhe shpesh paraqiten si hipovitaminoza multivitaminike të kombinuar (*Biokimia.2016. f..438*).

## **Kalciferoli, kalciol, kalcitrol (vitamina D)**

Vitamina D është një emër i grupit që përfshijnë disa përfaqësues të cilët nga aspekti kimik janë shumë të përafert me steroidet ndryshe paraqesin derivate steroide, përgjegjëse për rritjen e përthithjes në zorrë të kalciumit, magnezit dhe fosfatit dhe shumë efekteve të tjera biologjike, njerëzve, përbërësit më të rëndësishëm në këtë grup janë vitamina D3 e njohur si kolekalciferol dhe vitamina D2 e njohur si ergokalciferol. Burim i rëndësishëm i vitaminës D është sinteza e kolekalciferolit në shtresat e poshtme të epidermës së lëkures përmes një reaksioni kimik që varet nga rrezet e diellit (*Biokimia.2016. f..446*).

Në fillim vitamina D është llogritur si vitamin me bazë që tek fëmijët me rahitis (pamjaftueshmëri e mineralizmit të eshtrave) gjendja e të cilës është përmirësuar me marrjen orale të kësaj vitamine. Disa nga produktet e pasura me vitamin D; vaji i peshkut, qumështi, vezët dhe kërpudhat. Burimi kryesorë i kësaj vitamin nuk është vetëm ushqimi edhe pse ai është shumë domethënëse, por prodhimi i saj në lëkurë pas daljes në diell. Doza e rekomaduar ditore për fëmije është 10-20 mikrogram ndërsa për të rriturit është dhjetë herë më pak (*Biokimia.2016. f..446*).

Ekzistojne dy forma të vitaminës D; ergokalciferoli (d2) kolekalciferoli(d3). Vitamina D3 është produkt i rrezatimit ultraviolet ergosterolin i cili haset në botën bimore. Vitamina D3 është biologjikisht më aktive dhe më pak aktive janë D4, D5, D6, dhe D7 të cilët fitohen me rrezatim UV të përbërësve të caktuar (*Biokima.2016. f..446*). Kalciferoli i përfshirë në ushqim absorbohet në zorrën e hollë me ndihmën e acideve biliare, pastaj me ndihmën e hilomikroneve bartet në mëlçi. Kolekalciferoli endogjen bartet nga lëkura në mëlçi me ndihmën e gjakut .Vitamina D nga organizimi eliminohet kryesisht përmes fecesit si e pandryshuar oksiduar ose e konjuguar .Funksioni biokimik-aktiviteti biologjik i vitaminës D duke u lidhur me proteinat lidhëse transportohet në gjak deri tek organet e tjera ;kërca,eshtra,dhe veshka përmes të cilëve e kontrollojnë metabolizmin e kalciumit, fosforit dhe magnezit në organizëm .Në përgjithësi marrja e vitaminës D e rrit koncentrimin e kalciumit dhe fosforit në gjak(*Biokimia.2016.f..446*) .

Vitamin D1-lumisterol është një përbërje që është pjesë e familjes së vitaminës D të përbërjeve steroide.

Steroizomeri i ergosterolit u prodhuan si një nënprodukt fotokimik në përgatitjen e vitaminës D1 e cila ishte një përzierje e vitaminës D2 dhe lumisterolit.




Vitamina D2 formohet nga lumisteroli nga një hapje unaze elektrociklike dhe ndërrim hidrid sigmatropik (*Dewick. Paul M .2002 f..257*) (*Friedmann. Ernst. 1989. vëllimi 1*).

Vitamina D2- Ergokalciferol, i njohur gjithashtu si vitamina D2 dhe jospecificisht kalciferoli, është një llojë i vitaminës D që gjendet në ushqim dhe përdoret si shtesë e dietës. Si shtojcë përdoret për të parandaluar dhe trajtuar mungesën e vitaminës D (*Coulston AM Boushey C. Ferruzzi M 2013. f..818*). Kjo përfshinë mungesën e vitaminës D për shkak të përthithjes së dobët nga zorrët ose sëmundjes së mëlçisë (*British Medical Association .2015. f..703-704*).

Vitamin D3- Cholekalciferol i njohur gjithashtu si vitamin D3 kolekalciferoli, është një lloj i vitaminës D e cila bëhet nga lëkura kur ekspozohet në rrezet e diellit: gjendet gjithashtu në disa ushqime dhe mund të merret si një shtesë dietike (*Coulston AM, Boushey C. Ferruzzi.2013. f..818*). Përdoret për të trajtuar dhe parandaluar mungesën e vitaminës D dhe sëmundjet shoqëruese, përfshinë rahitisin. Përdoret gjithashtu për hipofosfememi familjare, hipoparatiroidizëm që po shkakton kalcium të ulët në gjak dhe sindromën Fanconi (*British national formular.2015. f..703-704*) (*World Health Organizatio. Stuart MC. Kouimtzis M. Hill SR. 2008. f..506*). Shtesat e vitaminës D mund të mos jenë efektive tek njerëzit me sëmundje të rëndë të veshkave (*Hmilton R .2015. f..231*). Dozat e tepërta tek njerëzit mund të rezultojnë në të vjella, kapsllëk, dobësi dhe konfuzion. Dozat më të mëdha se 40,000IU në ditë zakonisht kërkohen para se të ndodhë kalcium i lartë në gjak. (*Veith R .1999. f..850-856*) (*The American journal of Clinical Nutrition.1969. f..56*).

Vitamin D4-dihidroergokalciferoli është një formë e vitaminës D, e njohur gjithashtu si vitamina D4. Vitamina D4 gjendet në kërpurdha të caktuara, duke u prodhuar nga ergosta-5,7-dienol në vend të ergosterolit (*Philips KM. Horst RJ. Koszewski NJ. Simon RR2012. f..40-702*).

Vitamin D5-analoget e calcitrolit janë të propozuarë për përdorim si agjente anti-tumor. Studimet mbi vitamin D3 kanë treguar frenim të përhapjes qelizore në kancerin e prostatës por doza të larta të vitaminës D3 rezultojnë në hiperkalcemi. Efektet e vitaminës D5 në kancerin e prostatës janë studiuar gjithashtu ,dhe ndryshe nga vitamina D3 (Mehta RG.Moriarty RM .Penmasta R.Lazzaro G.Constantinou A.Guo L.1997.f..212-8). Vitamina D5 nuk shkakton hiperkalcemi ndërsa pengon përhapjen e qelizave tumorale. Analogu më i hulumtuar i vitaminës D5 si një agjent anti-tumor është 1 $\alpha$ -Hydroxyvitamin D5 (Mooso B.Madhav A.Johnson S.Roy M.Moore ME.Moy C.Loredo GA.Mehta RG.Vaughan AT.Ghosh PM2010.f..927-940).

Emri	Opsionet kimike	Struktura
Vitamin D1	Përzierje e përbërjeve molekulare të ergocalciferoli me lumisterol.	
Vitamin D2	Ergocalciferol (është bërë nga ergosteroli).	
Vitamin D3	Cholecalciferol (është bërë nga 7-dehydrocholesterol në lëkurë).	
Vitamin D4	22-dihydroergocalciferol	




Vitamin D5	Sitocalciferol (është bërë nga 7-dehydrositosterol).	
------------	--	---

Table 3: struktura kimike e vitaminave D1, D2, D3, D4, D5

Biologji -vitamina D gjithashtu ndikon në sistemin imunitar dhe në disa qeliza të bardha të gjakut duke përfshirë monocitet dhe qelizat T dhe B te aktivizuar (Watkins RR. Lemonovich TL. Salata RA. 2015. f..363-8). In vitro, vitamina D rrit shprehjen e gjenit të hidroksilazës së tiroksinës në qelizat medullare të veshkave dhe ndikon në sintezën e faktoreve neurotrofike, sintezën e oksidit nitrik dhe glutatonin (Puchacz E, Stumpf WE. Stachowiak EK. Stachwiak MK 1996. f..193-36).

### Mungesa e vitaminës D

Sasia jo adekuate e vitaminës D tek fëmijët çon në paraqitjen e sëmundjes së njohur si rahitisi. Kjo ndodh më shpesh si pasojë e koncentrimin të ulët të vitaminës D në ushqim, gatë rrezatimit të ulët ultraviolet të dritës si pasojë e prodhimit endogjen dhe pjesëmarrjes së ulët në indin (më shpesh i referohet mungesës së calciferolit-receptorëve lidhëse) (Biokimia. 2016. f..448). Tek rahitisi, të gjitha proceset janë të kontrolluar nga vitaminat D inhibohen. Për atë shkak nivelin i Ca dhe P në gjak është i ulët, mineralizimi eshtrave shkatërrohet, me çka nuk ka depozitim të materieve mineraleve në matriksin kolagjen të formuar në eshtra të cilat rriten (Biokimia. 2016. f..448). Ashtu që ndodh deformimi i eshtrave dhe deficitit i vitaminës D tek të rriturit çon në osteomalaki, eshtrat kanë strukturë të dobët dhe lehtë thehen. Mungesa relative e vitaminës D mund të paraqitet edhe kur vitamina D merret në sasi normale, dhe veçanërisht veshkat janë të sëmura dhe nuk ka prodhim të formës aktive të vitaminës D (Biokimia. 2016. f..448).

## **Hipervitainoza e vitaminës D**

Marrja e tepruar e vitaminës D çon në intoksikim të vitaminës te fëmijët dhe te të rriturit. Kjo manifestohet me demineralizimin e eshtrave dhe rritjen e shpeshtësisë për frakturat. Niveli i Ca dhe P në gjak është shumë i rritur. Kjo çon në kalcifikimin e organeve të brendshme: elementeve të gjakut, mushkërive dhe veshkëve etj. Preparatet me vitamin D shfrytëzohen në profilaksë dhe terapi të rahitisi dhe në shërimin e sëmundjeve të tjera: tuberkuloza e kockave, muskujve si dhe lëkurës (*Biokimia. 2016. f..449*).

Osteomalacia është zakonisht e pranishme kur nivelet e 25-hidroksivitaminës janë më ulët pak se rreth 10mg/ml, efektet e osteomalacisë mendohet kontribojnë në dhimbjen kronike muskuloskeletale(*Holick MF.2006.f..353-73*), nuk ka asnjë prove bindëse të niveleve më të ulëta të vitaminës D në të sëmurët me dhimbje kronike (*Straube S.Andrew Moore R.Derry S.McQuayHJ 2009.f..10-3*)ose që plotësimi lehtëson dhimbjen kronike jospecifike muskulo-skeletore(*Gaikward M.Vanilnt S.Mittinity M .Moseley GL .Stocks N 2017.f..1201-1208*).

Diabeti -Plotësimi i vitaminës D3 ka një efekt në homeostazën e glukozës ose parandalimin e diabetit. Mungesa e vitaminës D mund të jetë një faktor rreziku për diabetin (*Seida JC. Mitri J. Colmers IN. Majmudar SR. DavidsonMB. Edwards AL.2014. f..3551-60*), provat e tepërta në lidhje me nivelet e vitaminës D dhe diabetit mellitus janë kontradiktore, duke kërkuar studime të mëtejshme (*Nakshima A. Yokoyama K. YokooT. Urashima M.2016. f..89-100*).

## **Vitamina D dhe sëmundja e mushkërive me fibrozë cistike (CF)**

Vitamina D është e njohur gjithnjë e më shumë si e përfshirë në një spektër të gjërë veprimesh biologjike, duke përfshirë efektet të rëndësishme imunomoduluese. Rrugët e frymarrjes së fibrozës cistike, karakterizohet nga të parregullta dhe të rritura në mënyrë disproporcionale, në lidhje me stimujt themelorë bakterial, përgjigjet inflamatore. Vitamina D rregullon citokinat dhe kemokinat pro-inflamatore që nxisin shkatërrimin e indeve dhe që japin me bollëk në mushkëritë CF. Sidoqoftë, megjithatë provat në rritje për një rol patofiziologjik të vitaminës D në inflamacionin e rrugëve të frymëmarrjes CF. (*Loanna Loukou. Barbara Boutopolou. Sotirios Fouzas. Konstantinos Douros. 2015. f..132-142*).

## **Vitamina D si një terapi anti -mikrobike dhe anti-inflamatore për fibrozë cistike (CF)**

Fibroza cistike karakterizohet nga infeksion kronik dhe inflamacion në rrugët e frymëmarrjes që çojnë në dëmtime progresive të mushkërive dhe vdekje të hershme. Terapitë aktuale anti-inflamatore janë të kufizuara nga efektet anësore ose efikasiteti i pamjaftueshmërisë. Ekziston një numër i madh i studimesh që tregojnë veti të dobishme anti-mikrobike dhe anti-inflamatore të vitaminës D. Meqenëse shumica e pacientëve me CF paraqesin mungesë të vitaminës D dhe nivelet e vitaminës D serumit tregojnë një korrelacion pozitiv me funksion të mushkërive dhe korrelacion negative me inflamacionin e rrugëve të frymëmarrjes dhe infeksioni ,korrigjimi i mungesës së vitaminës D mund të jetë një strategji tërheqëse terapeutike në CF. Funksioni i vitaminës D është i lidhur ngushtë me metabolizmin e saj,i cili mund të dëmtohet në hapa të shumtë në pacientët me CF,me një potencial për të kufizuar efikasitetin e plotesimit të vitaminës D.Ky rishkim do të ilustrojë potencialin për plotësimin me vitamin D ose metabolitet e saj për të moduluar inflamacionin dhe për të përmirësuar mbrojtjen kundër infeksionit kronik në mushkëritë

CF, si dhe strategjitë e përshtashme të plotesimit të vitaminës D për përmirësimin e funksionit të mushkërive (*KHerscovitch. N Dauletbaev. Larry C Lands.2014. f..154-162*).

### **Trajtimi i vitaminës D në fibrozë cistike (CF)**

Mungesa e vitaminës D ndodh shpesh në pacientët me fibroze cistike. Vitamina D është e rëndësishme për mineralizmin optimal të kockave dhe mund të jetë e rëndësishëm për sëmundjet e tjera shoqëruese që ndodhin zakonisht te pacientët me CF. Mungesa e vitaminës D në pacientet me CF mund të lindë nga shkaqe të ndryshme duke përfshirë pamjaftueshmërinë ekzokrine të pankreasit, mungesën e aktivitetit në natyrë dhe ndryshimet e metabolizmit të vitaminës D. Për shkak të keqthithjes së yndyrës që rrjedh nga pamjaftueshmëria e pankreasit, doza më të larta orale të vitaminës D janë të nevojshme për të korrigjuar dhe mbajtur statusin optimal të vitaminës D në pacientët me CF. Studimet e fundit kanë demonstruar se statusi më i lartë i vitaminës D shoqërohet me një funksion më të mirë të mushkërive dhe se terapia me vitamin D mund të ndihmojë në rimekembjen nga përkeqësimet pulmonore të CF. Mekanizmat me të cilët vitamina D mund të ushtrojë veprimet e saj të dobishme me CF janë të paqarta, por ka të ngjarë të lidhen me rolin që ka vitamina D në modulimin e reagimit imunitar adaptiv dhe të lindur. Janë të nevojshme studimet të mëdha të rastësishme klinike për të vlerësuar rolin e mundshëm të vitaminës D si terapi shtesë në CF që shkon përtej kockave (*Supavit Chesdachai. Vin Tangpricha .2016. f..36-39*).

### **Vitamina D në sëmundjen kronike të veshkave para-dializës**

Pacientët me sëmundje kronike të veshkave kanë një prevalencë të lartë të pamjaftueshmërisë /mungesës së vitaminës D. Mungesa e vitaminës D është e shoqëruar me një sërë çrregullimeve të kockave, metabolike dhe kardiovaskulare. Sidoqoftë, roli i suplementit të vitaminës D (ergocalciferol, calciferol ose calcifediol) mbetet i paqartë në sëmundjen kronike të veshkave (CKD), veçanërisht në fazën para-dialitike (*Mariana P Cardoso. Luciano A L Pereira.2019. f..18-28*).

## **Vitamina D në pacientët me sëmundje kronike të veshkave (CKD) dhe dializë**

Mungesa e vitaminës D dhe pamjaftueshmëria janë të zakonshme midis pacientëve me sëmundje kronike të veshkave (CKD) ose që i nënshtrohen dializës. Përveç deficiteve të ekspozimit ushqyes dhe rrezeve të diellit, faktorë që ndikojnë në mungesën e vitaminës D përfshijnë racën, seksin, moshën, mbipeshën dhe sinteza dhe metabolizmin e dëmtuar të vitaminës D. Nivelet e serumit 1,25 dihydroxyvitamin D gjithashtu zvogëlohen në mënyrë progresive për shkak të mungesës së 25 hydroxy vitamin D nga qelizat tubulare proksimale renale, faktori i lartë i rritjes së fibroblastit (FGF)-23 dhe renale funksionale të ulura të indeve. Ashtu si në popullatën e përgjithshme, kjo gjendje shoqërohet me rritje të sëmundjeshmerise dhe rezultateve të dobëta. Së bashku me rënien progresive të kalçitrolit në serum, mungesa e vitaminës D çon në hiperparatiroidizëm sekondar (SHPT) dhe ndërlikimet e tij, hipertiroidizëm terciar dhe hiperkalcemi, të cilat kërkojnë paratiroidektomi kirurgjikale ose kalsimimetike. Nisma për cilësinë e rezultateve të sëmundjeve të veshkave (KDOQI) dhe ekspertet për përmirësimin e rezultateve globale të sëmundjeve të veshkave (KDIGO) kanë që pamjaftueshmëria dhe mungesa e vitaminës D duhet të shmangen tek pacientët me CKD dhe dializë duke përdorur suplemente për të parandaluar SHPT. Janë raportuar shumë regjime të plotësimit të vitaminës D duke përdorur ose ergociferol ose kolekalciferol çdo dite, javore ose mujore. Vitamina D ka efekte pielotrope në sistemin imunitar, kardiovaskular dhe neurologjik dhe në aktivitetin antineoplastik. Organet ekstra-renale posedojnë aftësinë enzimatiske për të shndërruar 25 hydroxy vitamin D në 1,25 dihydroxyvitamin D (*Guillaume Jean. Jean Claude Souberbielle. Charles Chazot. 2017. f..328*).

## Vitamina D dhe sëmundjet autoimune

A është polimorfizimi i receptorit të vitaminës D (VDR) fajtor?

